

Bartësi Privat i Arsimit të Lartë
Private Bearer of Higher Education



KOLEGJI I SHKENCAVE MJEKËSORE "REZONANCA"
COLLEGE OF MEDICAL SCIENCES "REZONANCA"
Prishtinë

Tel: +381 38 544-754
Fax: +381 38 544-756

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

Datë:	27.12.2018
Nr. referencës	7069/18
Për:	
CC:	
Përmes:	
Nga:	Kolegji i Shkencave Mjekësore "REZONANCA", Prishtinë
Subjekti:	STATUTI PËR QEVERISJE

STATUTI

Prishtinë, 2018

Senati i Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca", në mbledhjen e mbajtur më datë 27.12.2018 e miratoi këtë Statut të Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca".

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji) është themeluar më 12 maj 2003, në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr.2003/14, në fillim si Universiteti i Shkencave Mjekësore.
2. Më 30.12.2008 bashkohet me Kolegjin "ILIRIA", si njësi akademike e saj.
3. Më 30.09.2014 ndahet nga Kolegji "Iliria" dhe të vazhdon veprimtarinë e vet si bartës privat i arsimit të lartë i pavarur.
4. Statuti i Kolegjit (në tekstin e mëtejshëm: Statuti), përcakton dhe rregullon misionin, organizimin, veprimtarinë dhe punën e Kolegjit, autorizimet dhe mënyrën e vendosjes së organeve të Kolegjit, rregullon zhvillimin e studimeve, statusin e personelit akademik dhe administrativ dhe të studentëve, çështjen e marrjes së masave disiplinore dhe çështje të tjera të rëndësishme për Kolegjin.

I.1. Emri, selia dhe simbolet

Neni 2

1. Emri i Kolegjit në gjuhën shqipe është: Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca".
2. Emri i Kolegjit në gjuhën angleze është: College of Medical Sciences "Rezonanca".
3. Emri i Kolegjit në gjuhën serbe është: Koledj medicinskih nauka "Rezonanca".
4. Selia e Kolegjit është në Prishtinë, rr. Gllugu te Shelgjet, Çagllavicë, Prishtinë.

Neni 3

1. Kolegji ka këto simbole:

1.1. Stemën

1.2. Vulën dhe vulën e thatë

1.3. Flamurin

2. Kolegji e ka emblemën me emrin e Kolegjit dhe emrin e vet brenda emblemës.

3. Vula dhe vula e thatë e kanë formën e rrumbullakët dhe në mes kanë emblemën e Kolegjit.

4. Data e përvjetorit të Kolegjit është 19 tetori (dita kur është bërë licencimi i i Institucionit për herë të parë – 19 tetor 2004).

I. 2. Misioni i Kolegjit

Neni 4

1. Kolegji është institucion privat i arsimit të lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkimet shkencore, këshillimet profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarisë akademike.

2. Misioni i përgjithshëm i Institucionit konsiston në:

- zhvillimin dhe zbatimin e koncepteve të reja të arsimit mjekësor të shekullit XXI në Kosovë.
- ofrimin, promovimin dhe zhvillimin e programeve studimore kualitative, sipas standardeve ndërkombëtare.
- ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme për punë kërkimore-shkencore në arsimin e lartë,
- krijimin e infrastrukturës institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve intelektuale për punë akademike dhe kërkimore-shkencore.
- pasurimin e sistemit shëndetësorë në komunitet me shërbimet cilësore, e posaçërisht të shërbimeve mjekësore deficitare në Kosovë për periudhën aktuale.

3. Kolegji ka këto qëllime:

1.1. të kontribuojë në avansimin e diturive, ideve dhe shkencave mjekësore në Kosovë;

1.2. të rritë mundësitë për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e tjerë që të studiojnë shkencat mjekësore, në mënyrë që të përfitojnë nga ky arsim gjatë jetës së tyre;

1.3. të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;

1.4. të krijojë dhe të mbështes standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe të mësimnxënies në lëmenjtë mjekësorë;

1.5. të ndikojë në rritjen e njohurive dhe të shkathtësive themelore për punë kërkimore-shkencore, për vlerësim të shkrimeve shkencore, për mendim kritik dhe analitik;

1.6. të bashkëpunojë maksimalisht me institucione të tjera arsimore dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;

1.7. të sigurojë edukim mjekësor në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, sipas programeve studimore të krahasueshme me institucionet tjera në hapësirën evropiane;

1.8. të respektojë rekomandimet dhe standardet e Federatës Botërore për Edukim Mjekësor, të deklaratës së Komisionit të Komunitetit Evropian lidhur me profilin dhe kompetencat e profesionistëve të shkencave mjekësore;

4. Objektivat kryesore strategjike të Kolegjit janë:

- të përmirësojë vazhdimisht aktivitetet arsimore-mësimore;
- të rritë e cilësisë dhe sasisë së aktiviteteve kërkimore;
- të rritë efektivitetin dhe të sigurojë qëndrueshmëri të praktikave të shërbimeve shëndetësore të komunitetit.
- të sigurojë efektivitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit të menaxhimit.

Neni 5

1. Kolegji obligohet të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë pa asnjë lloj diskriminim në kuptim të gjinisë, racës, statusit martesor, gjuhës, religjionit, besimit politikë, përkatësisë kombëtare, etnike ose sociale apo ndonjë statusi tjetër.

2. Kolegji obligohet të mbështet barazin gjinore. Kjo do të thotë që në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i plotësojnë kushtet e njëjta, përparësi do t'i ipet gjinisë femërore.

Neni 6

1. Kolegji gëzon lirinë e mësimdhënies akademike, autonominë organizative dhe financiare.

2. Liria e mësimdhënies akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor. Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet dhe programet mësimore të miratuara për të gjitha degët e sudimeve që ka Kolegji.

I. 3. Të drejtat dhe detyrat

Neni 7

1. Kolegji i ka këto të drejta:

1.1. Të rregullojë strukturat dhe aktivitetet e tij nëpërmjet rregullave të Kolegjit, e në përputhje me ligjet në fuqi dhe me akte të tjera të nxjerra nga këto ligje;

1.2. Të zgjedhë personelin mësimor dhe personelin tjetër të nevojshëm;

1.3. Të përcaktojë numrin dhe kushtet për pranimin e studentëve të rinj, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit të studentëve;

1.4. Të zhvillojë dhe të zbatojë në mënyrë të pavarur planprogramet, kërkimet shkencore dhe projektet tjera;

1.5. Të bëjë përcaktimin e fushave për studim;

1.6. Të vendosë marrëdhënie me shkolla të larta të vendit e të huaja;

1.7. Të anëtarësohet në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë;

1.8. Të bashkëveprojë me fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë

Neni 8

1. Kolegji gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrat, të cilat përveç atyre të përfshira në nenin 7 të Statutit, përfshijnë edhe:

- 1.1. të drejtën për të paditur dhe të jetë i paditur;
- 1.2. rregullimin e organizimit të vet të brendshëm;
- 1.3. të drejtën të përdorë vulën dhe emblemat;
- 1.4. të drejtën të kufizojë përdorimin e titullit të tij vetëm për personat dhe organizatat që e kanë autorizimin e tij;
- 1.5. të drejtën e disponimit të mjeteve sipas ligjeve në fuqi;
- 1.6. të drejtën e zotërimit dhe të administrimit të pasurisë;
- 1.7. pranimin dhe administrimin e fondeve nga çdo burim i ligjshëm;
- 1.8. përcaktimin dhe pranimin e tarifave;
- 1.9. nënshkrimin e kontratave për mallra dhe shërbime;
- 1.10. miratimin e rregulloreve të tjera të brendshme të njësive përbërëse të Kolegjit;
- 1.11. vendosjen e marrëdhënieve juridike me studentët;
- 1.12. zhvillimin e sistemit për vlerësim dhe sigurim të cilësisë;
- 1.13. punësimin dhe shkarkimin e personelit për arsye të forta.

Neni 9

1. Të gjitha mjediset (ndërtimet dhe trojet) që janë në administrim të Kolegjit, si dhe çdo mjedis i fitur në të ardhmen në bazë të ligjit, gëzojnë paprekshmëri, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me ligje të veçanta.

Neni 10

1. Kolegji ofron mundësi të barabarta për punësim dhe barazi në studime.

Neni 11

1. Puna në Kolegj është publike.

II. Qeverisja e Kolegjit

Neni 12

1. Organet kryesore të Kolegjit janë: Këshilli Drejtues, Senati, Rektori dhe Bordi i Kolegjit.
2. Kolegji, për menaxhimin efikas të kurseve mjekësore, vë në funksion edhe organe të tjera në strukturën menaxhuese, dhe ato: Departamentet, Bordin e Ekzaminuesve (BE), Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC), Zyra për Resurse Humane (ZRH), Komisioni për Evaluimin Permanent të Kurikulumeve (KEPK), Qendra për Mësimdhënie dhe Mësim (QMM), Zyra për ECTS, Zyra për Koordinim me Komitetin Nacional për Provimin Final, Instituti Kërkimoro-Shkencor, Komiteti Etik, Qendra për Publikime, Zyra për Marrëdhënie me Jashtë, Biblioteka qendrore, Qendra për Karrierë dhe Zyra e Alumnit, Zyra për IT dhe Moodle platformë, Njësitë Mësimore të Stomatologjisë, Njësitë Mësimore të Farmacisë, Njësitë Mësimore të Departamentit të Shkencave Themelore, Njësitë Mësimore të Departamentit të Shkencave Klinike.

II. 1. Këshilli drejtues i Kolegjit

1. Këshilli drejtues i Kolegjit (më tej 'Këshilli drejtues') është autoriteti kryesor qeverisës i Kolegjit.
2. Këshilli drejtues ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të Kolegjit.
3. Këshilli drejtues është përgjegjës për të gjitha vendimet në lidhje planin strategjik të zhvillimit dhe me çështjet financiare (buxheti, personeli, infrastruktura), në mënyrë që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të Kolegjit në përputhje me obligimet e tij.
4. Këshilli drejtues mund të formojë komisione të përkohshme për ta këshilluar atë lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.
5. Këshilli drejtues formon Komisionin për çështje statutare si komision këshillëdhënës. Komisioni informon autoritetet e Kolegjit lidhur me të gjitha rastet e moszbatimit të Statutit dhe akteve tjera në çështjet e caktuara, nga autoritetet

kompetente si dhe merr pjesë në hartimin ose jep mendimin në procedurën e përgatitjes së akteve dhe rregulloreve të nxjerra nga Kolegji. Këshilli drejtues me akt të veçantë rregullon çështjet lidhur me Komisionin për çështje statutare.

6. Këshillin Drejtues të Kolegjit e përbëjnë Presidenti i Kolegjit, Rektori i Kolegjit, Menaxheri general i Kolegjit, 3 prorektorët dhe 3 dekanët e fakulteteve.

Neni 13

1. Detyrat e Këshillit drejtues janë:

- 1.1. Të organizojë procesin e rishikimit të vizionit, misionit dhe të objektivave strategjike të Kolegjit në mënyrë periodike, sipas ndryshimit të rrethanave, të cilat ia propozon Senatit për miratim;

- 1.2. Të sigurojë parakushte për administrim dhe menaxhim të drejtë të burimeve në nivel të Kolegjit dhe njësive të tij vartëse;

- 1.3. Të nxjerrë rregullore për delegim të kompetencave për mjetet dhe çështjet e tjera administrative të njësitë akademike të Kolegjit në përputhje me dispozitat e këtij Statuti;

- 1.4. Të nxjerrë rregullore për qeverisjen, drejtimin dhe menaxhimin e Kolegjit, siç kërkohet me këtë Statut;

- 1.5. Të vendosë për strukturën e përgjithshme organizative të njësive akademike, sipas propozimit të Senatit dhe pasi të jenë konsultuar njësitë në fjalë;

- 1.6. Të organizojë kontrollin financiar në pajtim me Ligjin dhe këtë Statut;

- 1.7. Të nxjerrë rregullore, në pajtim me këtë Statut, në lidhje me:

- 1.7.1. Masat dhe procedurën disiplinore për personelin akademik dhe studentët;

- 1.7.2. Pagesat dhe kushtet e shërbimit për personelin;

- 1.7.3. Procedurat e mënyrave të kompensimit të personelit, në bazë të ankesave në lidhje me punësimin e tyre;

- 1.7.4. Suspendimin apo shkarkimin nga puna të personelit;

- 1.7.5. Ankesat kundër pezullimeve dhe shkarkimeve të tilla.

1.8. T'i propozoj tarifat e pagesave të shkollimit që duhet të paguajnë studentët e pranuar, dhe në disa raste të përcaktojë tarifat për shqyrtimin e aplikacioneve për regjistrim, për përsëritjen e provimeve dhe për diplomim.

1.9. Të përcaktojë rregulla për llogaritjen e shpenzimeve për shërbimet akademike, që i ofrohen palëve të treta;

Neni 14

1. Këshilli drejtues do të publikojë raportin vjetor mbi plotësimin e punës së Kolegjit në përputhje me kërkesat e Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Raporti duhet të ofrojë informata lidhur me këto aspekte:

1.1. Objektivat e përgjithshme strategjike të arritura;

1.2. Të dhënat statistikore për tërë Kolegji dhe njësitë e tij akademike dhe organizative në lidhje me burimet:

1.2.1. Buxheti,

1.2.2. Personeli (shifrat zhvillimore);

1.2.3. Infrastruktura;

1.2.4. Profilin akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.);

1.2.5. Programet e studimit;

1.2.6. Numrin e studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit);

1.2.7. Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet);

1.2.8. Bashkëpunimin ndërkombëtar;

2. Raportin vjetor të auditorit për shfrytëzimin e duhur të mjeteve.

3. Raportet duhet të publikohen në web faqen e Kolegjit

Neni 15

II.2. Senati

1. Senati është organi më i lartë akademik i Kolegjit.

Neni 16

1. Senati përbëhet nga këta anëtarë me të drejtë vote:

- rektori,
- 3 prorektorë (prorektori për mësim, prorektori për shkencë, prorektori për bashkupunim me jashtë dhe cilësi),
- 3 dekanë të fakultetit (dekani i Fakultetit të Stomatologjisë, Dekani i Fakultetit të Farmacisë dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore),
- 7 përfaqësues të zgjedhur nga Njësitë Mësimore të Shkencave Themelore Biomjekësore,
- 5 përfaqësues të zgjedhur nga Njësitë Mësimore të Shkencave Klinike,
- 1 përfaqësues i zgjedhur nga Njësitë Mësimore të Stomatologjisë,
- 1 përfaqësues i zgjedhur nga Njësitë Mësimore të Farmacisë,
- 5 përfaqësues të zgjedhur nga departamentet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore,
- 2 përfaqësues të zgjedhur nga stafi joakademik,
- sekretari i Kolegjit dhe
- 9 përfaqësues të zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.

2. Nëntë anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve prej radhëve të studentëve të rregullt të Kolegjit. Studentet anetare të senatit duhet të jenë student të dalluar me note mesatare se paku të tete (8), dhe nuk duhet të jenë përsëritës të vitit akademik.

3. Sekretari i Kolegjit është anëtar i përhershëm i Senatit, pa të drejtë vote.

Neni 17

1. Mandati i anëtarëve akademikë dhe joakademikë të Senatit është katër vite.
2. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një vit, pa të drejtë të rizgjedhjes.
3. Mandati i tyre fillon më 1 tetor.

Neni 18

1. Senatin e kryeson Rektori, në mungesë të tij, Senatin e kryeson prorektori të cilin e cakton rektori sipas radhës.

Neni 19

1. Senati nxjerr rregulloren e punës dhe rregulloren për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të tij.
2. Rektori cakton procedurat për mbledhjet e Senatit dhe të komisioneve të tij.

Neni 20

1. Pavarësisht nga përgjegjësitë e Këshillit drejtues dhe Rektorit, Senati është përgjegjës për:
 - 1.1. Çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie dhe kurset në Kolegj
 - 1.2. Miratimin e deklaratës së misionit të Kolegjit;
 - 1.3. Kriteret për pranimin e studentëve;
 - 1.4. Miratimin e propozimeve nga Keshilli i Fakultetit për zgjedhjen dhe avansimin e personelit akademik;
 - 1.5. Politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe mbajtjen e provimeve për konstatimin e punës akademike të studentëve;
 - 1.6. Miratimin e përmbajtjes së planprogrameve;
 - 1.7. Sigurimin e mësimin tërë jetësor;
 - 1.8. Standardet akademike dhe validitetin dhe rishikimin e kurseve;
 - 1.9. Sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin;
 - 1.10. Procedurën për dhënien e kualifikimeve dhe të titujve akademikë të nderit;
 - 1.11. Procedurën për përjashtimin e studentëve për arsye akademike apo të tjera;
2. Zhvillimin e strategjisë për aktivitetet akademike në Kolegj dhe për mjetet e nevojshme për t'i mbështetur ato si dhe ofrimin e këshillave për rektorin dhe Këshillin drejtues;

3. Zhvillimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale të Kolegjit dhe shfrytëzimin komercial të saj;
4. Sigurimin e këshillave për çështje të tjera që Këshilli Drejtues ose rektori mund të kërkojnë nga Senati.

Neni 21

1. Detyrat e Senatit janë:

- 1.1. Të aprovoj Statutin e Kolegjit, të propozuar nga Këshilli drejtues;
- 1.2. Të zgjedhë anëtarët e Këshillit drejtues që propozohen nga Kolegji;
- 1.3. Të formoj Komisionin profesional prej pese (5) anëtarëve për propozimin e listes për rektor;
- 1.4. Miraton propozimin e Këshillave të njësive akademike për zgjedhjen e dekanëve dhe prodekanëve;
- 1.5. Të inicon procedurën për shkarkimin e dekanëve dhe prodekanëve sipas procedurës së caktuar me këtë statut;
- 1.6. Të lëshojë vendime për pranimin dhe shuarjen e njësive akademike dhe të propozojë ndryshime të tjera në status të tyre për miratim nga ana e Këshillit drejtues;
- 1.7. Të miratojë programet e studimeve të njësive akademike;
- 1.8. Të përpilojë strategji për zhvillimin akademik të Kolegjit;
- 1.9. Të nxjerrë rregullore të përgjithshme për fushat e punës arsimore, kërkimore dhe artistike;
- 1.10. Të caktojë procedura dhe kritere për vlerësimin e mësimdhënies, punës shkencore dhe artistike;
- 1.11. Të propozojë kriteret për regjistrimin e studentëve, në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin mbi Arsimin e Lartë;
- 1.12. Të vendos për kriteret për përjashtimin e studentëve;
- 1.13. Të definojë standardet akademike për ligjërata dhe për sigurim të cilësisë së mësimëve, në pajtim me këtë Statut;

- 1.14. Të përcaktojë përmbajtjen e të gjitha të dhënave akademike dhe dokumentacionit sipas këtij Statuti;
- 1.15. Të vendosë procedurën për vlerësimin e personelit akademik në përputhje me këtë Statut;
- 1.16. Të zgjedhë anëtarët për të gjitha komisionet dhe këshillat që i formon Senati;
- 1.17. Të marrë vendimet përfundimtare duke i marrë parasysh kundërshtimet e dhëna nga këshillat e njësive akademike;
- 1.18. Të vendosë për dhënien e titullit Dr. honoris causa;
- 1.19. Të vendosë për dhënien e titullit Profesor emeritus sipas dispozitave të këtij Statuti.
- 1.20. Të vendosë për dhënien e titullit Anëtar Nderi i Kolegjit;
- 1.21. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të Këshillit drejtues apo rektorit;
- 1.22. Të shqyrtojë çështjet me propozim të Këshillit të njësive akademike;
- 1.23. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të parlamentit të studentëve;
- 1.24. Të nxjerrë rregulloren e punës së Senatit;
- 1.25. Të shqyrtojë çështje të tjera siç përcaktohen nga ky Statut ose me kërkesën e Këshillit drejtues, rektorit, këshillave të fakulteteve ose Parlamentit Studentor.

Neni 22

1. Senati mund të formojë këshilla ose komisione të përkohshme për ta këshilluar atë lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.
2. Senati ka një komision të përhershëm, të quajtur Komisioni i studimeve, sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 23

II.3. Bordi i Kolegjit

1. Bordi i Kolegjit është një organ i thirrur nga rektori përgjegjës për administrimin e ditë-për-ditshëm të Kolegjit.

2. Bordi përbëhet nga Rektori, prorektorët, dekanët dhe një student.

II.4. Rektori

Neni 24

1. Rektori është autoriteti kryesor menaxhues i Kolegjit.
2. Rektori është përgjegjës për punën efektive dhe të rregullt të Kolegjit dhe për menaxhimin e tij sipas politikës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues, dhe ka gjithë autoritetin e nevojshëm për ushtrimin e këtyre detyrave.
3. Detyrat e rektorit specifikohen në kontratën e punës.
4. Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues.
6. Emërimi i rektorit bëhet për një periudhë prej katër vitesh, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.
7. Mandati i rektorit fillon me një tetor.
8. Këshilli Drejtues në konsultim me Senatin nxjerr rregulloren për procedurën e zgjedhjes dhe mandatin e Rektorit.

Neni 25

1. Rektori ka këto përgjegjësi :
 - 1.1. Të veprojë në emër të Kolegjit dhe ta përfaqësojë atë para publikut të gjerë;
 - 1.2. Të organizojë, drejtojë dhe menaxhojë Kolegjin;
 - 1.3. Të udhëheq personelin akademik;
 - 1.4. Të vendosë për rregulloren e punës për personelin akademik të Kolegjit në kuadër të kornizës së caktuar nga Këshilli drejtues;

- 1.5. Të punësojë, delegojë, nivelizojë, promovojë, suspendojë dhe të përcaktojë kushtet e punës për personel në pajtim me rregulloret e nxjerra nga Këshilli drejtues dhe Senati;
- 1.6. Ta kryesojë Senatin;
- 1.7. Të paraqesë para Këshillit drejtues propozime në lidhje me karakterin arsimor dhe misionin e Kolegjit duke marrë parasysh rekomandimet dhe mendimin e Senatit;
- 1.8. Të zbatojë vendimet e Këshillit drejtues;
- 1.9. Të menaxhojë buxhetin dhe mjetet në kuadër të shumës së miratuar nga Këshilli drejtues;
- 1.10. Të prezantoj raportin vjetor të buxhetit për të hyrat dhe shpenzimet për vlerësim nga Këshilli drejtues;
- 1.11. Të nënshkruajë kontrata në emër të Kolegjit me palët e treta;
- 1.12. Të nënshkruajë diplomat dhe certifikatat e tjera zyrtare të Kolegjit;
- 1.13. Të propozojë kandidatët për postin e prorektorëve, për t'u zgjedhur nga Këshilli Drejtues;
- 1.14. Të propozoj kandidatët për postin e sekretarit të përgjithshëm;
- 1.15. Të shpallë të gjithë titujt akademikë;
- 1.16. Rektori ka të drejtë të formojë komisione këshillëdhënëse;
- 1.17. Të kryejë të gjitha detyrat e tjera në emër të Kolegjit, siç janë përcaktuar me këtë Statut apo me rregulloret e tjera në fuqi.

Neni 26

Autoriteti i Rektorit do të simbolizohet përmes gjerdanit të Rektorit.

Neni 27

1. Mandati i Rektorit mund të përfundojë para kohe në rast të:
 - 1.1. Dorëheqjes;
 - 1.2. Shkarkimit nga detyra;
 - 1.3. Arsyeve shëndetësore;
 - 1.4. Dënimit për vepër penale;
 - 1.5. Pensionimit;
 - 1.6. Vdekjes.
2. Procedurat për shkarkimin e rektorit mund të iniciohen me shumicën absolute të votave nga:
 - 2.1. Këshilli drejtues;
 - 2.2. Senati.
3. Procedura për shkarkimin e rektorit përcaktohet me rregulloret e nxjerra nga Këshilli drejtues. Vendimi i Këshillit drejtues për shkarkim është valid me shumicën e kualifikuar të 2/3 të votave të anëtarëve.
4. Në rast të shkarkimit të rektorit përfundon edhe mandati i prorektorëve.
5. Në rast të shkarkimit, rektori dhe prorektorët e posa zgjedhur, do të zgjidhen për periudhën e mbetur të mandatit të rektorit të shkarkuar.
6. Në rastin e shkarkimit të rektorit, apo në çfarëdo rasti të mbetjes vakant të pozitës së rektorit, Këshilli Drejtues zgjedh ushtruesin e detyrës së rektorit deri në përfundimin e procedurës të zgjedhjes së rektorit për mandatin e mbetur. Ushtruesi i detyrës së rektorit do të

mbaj postin e rektorit deri në fund të mandatit, në qoftë se deri në shpalljen e zgjedhjeve në Kolegj kanë mbetur jo më shumë se 6 muaj. Ushtruesi i detyrës së rektorit zgjidhet personi që i plotëson kushtet e parapara për zgjedhjen e rektorit.

Neni 28

Prorektorët

1. Kolegji ka tre (3) prorektorë.
 - 1.1. Prorektorin për çështje Akademike;
 - 1.2. Prorektorin për Kërkimeve shkencore;
 - 1.3. Prorektorin për Bashkëpunimit ndërkombëtar, Zhvillim dhe Cilësisë.
2. Rektori e emëron njërin nga prorektorët për të ushtruar përkohësisht detyrën e Rektorit në rast të pamundësisë apo paaftësisë së përkohshme të Rektorit.

Neni 29

1. Rektori propozon listën e emrave për prorektorë nga radha e profesorëve të Kolegjit, pasi të jetë konsultuar me Senatin. Prorektorët zgjidhen nga Këshilli drejtues me shumicën absolute të votave, në një radhë votimi. Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet atëherë rektori ka të drejtë të propozojë kandidatin e ri.
2. Mandati i prorektorëve është i lidhur me atë të rektorit, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Neni 30

1. Mandati i prorektorëve mund të përfundojë para kohe në rast të:

- 1.1. Dorëheqjes;
 - 1.2. Shkarkimit;
 - 1.3. Arsyeve shëndetësore;
 - 1.4. Dënimit për vepër penale;
 - 1.5. Pensionimit
 - 1.6. Vdekjes.
2. Procedura për shkarkimin e prorektorit mund të iniciohet me shumicën absolute të votave nga:
- 2.1. Këshilli drejtues;
 - 2.2. Senati;
 - 2.3. Rektori.
3. Procedura për shkarkimin e prorektorit përcaktohet në rregulloret e nxjerra nga Këshilli drejtues. Vendimi i Këshillit drejtues për shkarkim bëhet valid me shumicën e kualifikuar të 2/3 të votave të anëtarëve.
4. Në rast të shkarkimit të prorektorit, rektori propozon kandidatin e ri për prorektor, i cili zgjidhet nga Këshilli drejtues për periudhën e mbetur të mandatit.

Neni 31

II.5. Struktura organizative

1. Kolegji përbëhet prej:
 - 1.1. Njësive akademike;
 - 1.2. Njësive organizative.
2. Njësitë akademike dhe Njësitë organizative nuk kanë subjektivitet juridik.

Neni 32

II.4. Njësitë akademike

1. Njësitë akademike të Kolegjit janë:
 - 1.1. Fakultetet.
2. Njësitë akademike kanë status të njëjtë sipas dispozitave që rregullojnë organizimin në këtë statut
3. Njësia akademike vepron në kuadër të kornizës institucionale të Kolegjit duke ofruar programe të arsimit të lartë, dhe kërkime shkencore.
4. Njësitë akademike krijohen me anë të integrit apo shpërbërjes së njësive të tjera me vendim të Këshillit drejtues dhe pas konsultimeve me Senatin.
5. Parakushtet për të fituar statusin e një njësie akademike janë:
 - 1.1. Veprimtaria në një apo në më shumë fusha të veçanta të arsimit akademik, në kërkime shkencore në kuadër të kornizës institucionale të Kolegjit;
 - 1.2. Infrastruktura e mjaftueshme;
 - 1.3. Numri i duhur i personelit akademik që mundëson plotësimin e kërkesave akademike për një periudhë afatgjatë,
6. Këshilli drejtues merr vendimin përfundimtar.
7. Njësia akademike humb statusin nëse:
 - 1.1. Vlerësohet negativisht nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dy herë radhazi;
 - 1.2. I nënshtrohet integrit apo shpërbërjes;
 - 1.3. Këshilli drejtues merr vendimin përfundimtar

Neni 33

1. Këshilli drejtues vendos për buxhetin vjetor të njësisë akademike sipas propozimit të rektorit dhe dëgjimit buxhetor me njësinë akademike.
2. Gjatë ndarjes së buxhetit duhet të merren parasysh nevojat e veçanta për obligimet mësimore, kërkimore, si dhe rezultatet e raporteve të mëhershme të punës dhe vlerësimet e njësive akademike

Neni 34

1. Njësia akademike si anëtare e Kolegjit është përgjegjëse për zbatimin e programeve të studimeve të akredituara në kuadër të profilit të saj arsimor dhe në përputhje me dispozitat e arsimit të lartë. Senati i cakton programet e studimeve.
2. Njësia akademike është përgjegjëse për zhvillimin e kërkimeve shkencore në kuadër të fushëveprimtarisë së saj.
3. Programet interdisiplinare të studimeve, që përfshijnë disa njësi akademike, do të themelohen me vendim të Senatit dhe sipas propozimeve të njësive akademike pjesëmarrëse.

Neni 35

II.5. Fakulteti

1. Fakulteti është i angazhuar në disiplinat akademike të:
 - 1.1. Arsimimit akademik;
 - 1.2. Kërkimit shkencor;
 - 1.3. Aktiviteteve të tjera të përcaktuara me këtë Statut.

Neni 36

1. Fakulteti ofron këto lloje të studimeve:
 - 1.1. Studimet themelore – bachelor;
 - 1.2. Studime themelore të integruara (pesëvjeçare, si p.sh. stomatologjia);
 - 1.3. Studimet master:
 - 1.3.1 Master shkencore dhe
 - 1.3.2 Master profesional, të cilet nuk mund të regjistrohen në studimet e doktoratës shkencore.

Neni 37

1. Në përbërjen e vet Kolegji i ka këto fakultete:

- 1.1. Fakulteti Stomatologjisë;
- 1.2. Fakulteti i Farmacisë;
- 1.3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Neni 38

1. Pavarësisht prej madhësisë (numrit të përgjithshëm të personelit akademik, numrit të mjaftueshëm të profesorëve të rregullt sipas nevojës së fushave të ndryshme akademike dhe përqindjes së personelit të përhershëm), fakulteti duhet t'i plotësojë standardet ndërkombëtare, në mënyrë që të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm dhe veprimtari profesionale në të gjitha fushat shkencore për një periudhë afatgjate.
2. Fakulteti e përqendron profilin e vet arsimor dhe kërkimor për nevojat e vendit, në riaftësimin dhe për mësimin gjatë gjithë jetës të profesionistëve, si dhe ofron shërbime praktike për partnerët vendorë.
3. Fakulteti ka të drejtë të themelojë institute për kërkime praktike në fusha të caktuara, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorët privatë ose publikë, me miratim të Këshillit drejtues.
4. Këshilli drejtues nxjerr rregullore mbi organizimin e brendshëm të njësive akademike me propozim të këshillit të njësisë akademike përkatëse.
5. Njësitë akademike kanë të drejtë të krijojnë këto nivele të nënndarjes hierarkike:
 - 5.1. Departamentet (fusha të përgjithshme të shkencës);
 - 5.1.1. Njësitë mësimore.
 - 5.2. Institutet (fusha speciale të shkencës),

Neni 39

1. Fakulteti është përgjegjës për sa vijon:
 - 1.1. T'i propozojë Senatit programet e studimeve;
 - 1.2. Të organizojë mësimdhënien, provimet dhe vlerësimet e studentëve;

- 1.3. Progresin akademik të studentëve, duke përfshirë shërbimet akademike të studentëve;
- 1.4. Të zhvillojë kërkime shkencore sipas standardeve ndërkombëtare;
- 1.5. Të sigurojë cilësinë, vlerësimin dhe çështjet e raportimit, siç është paraparë me këtë Statut;
- 1.6. Të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet, siç është paraparë me këtë Statut;
- 1.7. Çështjet e personelit sipas dispozitave të këtij Statuti;
- 1.8. Të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet e alokuara nga Këshilli drejtues.

Neni 40

1. Çdo fakultet udhëhiqet nga dekani të cilin, sipas vendimit të Senatit, mund ta ndihmojnë një, dy ose tre prodekanë.
2. Fakultetet që veprojnë në më shumë se një lokacion, kanë të drejtë edhe për nga një prodekan për secilin lokacion.

Neni 41

1. Dekanët dhe prodekanët zgjedhen nga Këshilli i njesise akademike me shumicën absolute të votave dhe i propozon Senatit për miratim për një periudhë katërvjeçare, nga radha e profesorëve të fakultetit përkatës, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.
2. Kandidatët për postin e dekanit dhe të prodekanit duhet të jenë individë me kualifikime relevante akademike dhe të kenë aftësi dhe përvojë në udhëheqje si dhe të kenë së paku thirrjen e profesorit asistent.
3. Dekani i zgjedhur i propozon Këshillit të njesisë akademike prodekanët e mundshëm për mandatin e përbashkët të cilët zgjedhen në Këshill dhe i percillen Senatit për miratim.
4. Për zgjedhjen e dekanit të ri, këshilli i njesise akademike zgjedh një delegat nga profesorët e fakultetit, i cili përkohësisht mban mandatin e dekanit në Këshill derisa

të përfundojë procedura e zgjedhjes së dekanit të ri. Pastaj dekani i ri merr mandatin ashtu siç parashihet me këtë Statut.

5. Mandati i rregullt i dekanit dhe i prodekanëve fillon me një (1) tetor.

Neni 42

1. Autoriteti i dekanit simbolizohet me zinxhirin e dekanit.

Neni 43

1. Mandati i dekanit mund të përfundojë para kohe në rast të:

- 1.1. Dorëheqjes;
- 1.2. Shkarkimit;
- 1.3. Arsyeve shëndetësore;
- 1.4. Dënimit për vepër penale;
- 1.5. Pensionimit
- 1.6. Vdekjes.

2. Procedura për shkarkimin e dekanit mund të iniciohet nga:

- 2.1. Këshilli drejtues;
- 2.2. Senati;
- 2.3. Rektori;
- 2.4. Këshilli i fakultetit përkatës.

3. Procedura dhe arsyet për shkarkimin e dekanit përcaktohen në rregulloren e nxjerrë nga Senati.

4. Vendimi për shkarkimin e dekanit merret nga Senati pasi të jetë bërë konsultimi me këshillin e fakultetit përkatës. Vendimi i Senatit merret me shumicën e kualifikuar të 2/3 të anëtarëve.

5. Në rast të përfundimit të mandatit të dekanit përfundon edhe mandati i prodekanëve.

6. Në rast të përfundimit të mandatit, dekani dhe prodekanët e posa zgjedhur do të zgjidhen për periudhën e mbetur të mandatit.

Neni 44

1. Mandati i prodekanit mund të përfundojë para kohe në rast të:
 - 1.1. Dorëheqjes;
 - 1.2. Shkarkimit;
 - 1.3. Arsyeve shëndetësore;
 - 1.4. Dënimit për vepër penale;
 - 1.5. Pensionimit
 - 1.6. Vdekjes.
2. Procedura për shkarkimin e prodekanit mund të iniciohet nga:
 - 2.1. Këshilli Drejtues;
 - 2.2. Senati;
 - 2.3. Rektori;
 - 2.4. Këshilli i fakultetit përkatës;
 - 2.5. Dekani.
3. Vendimi për shkarkim merret nga Senati pasi të jetë konsultuar me dekanin dhe këshillin e fakultetit përkatës. Vendimi i Senatit për shkarkim nga posti merret me shumicën e kualifikuar të 2/3 të anëtarëve.
4. Në rast të përfundimit të mandatit të prodekanit, dekani propozon kandidatin e ri në detyrën e prodekanit, i cili zgjidhet për periudhën e mbetur të mandatit të prodekanit të shkarkuar.

Neni 45

1. Dekani për punën e tij i përgjigjet rektorit. Detyrat e dekanit janë:
 - 1.1. Të sigurojë udhëheqje akademike në fushat përkatëse për zhvillimin e mësimin, punës shkencore në fakultet;

- 1.2. Të sigurojë shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe efektiv të mjeteve të alokuara për fakultetin nga Këshilli drejtues;
 - 1.3. Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në zbatimin e vendimeve dhe detyrave të përcaktuara nga Këshilli i fakultetit;
 - 1.4. Të sigurojë informata të mjaftueshme në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve dhe rezultateve në mësim, në kërkime shkencore për rektorin dhe Këshillin drejtues sipas dispozitave të këtij Statuti;
 - 1.5. Të përfaqësojë Këshillin e Fakultetit në Senatin e Kolegjit;
 - 1.6. T'i japë këshilla rektorit dhe Senatit për emërimin e personelit akademik në lëndët e fakultetit;
 - 1.7. Të propozojë kandidatët për prodekanë;
 - 1.8. T'i kryejë detyrat e tjera të dekanit që parashihen në këtë Statut.
2. Dekani mund të përfaqësojë Kolegjin edhe për çështjet ligjore në emër të fakultetit vetëm me autorizim të Këshillit drejtues të paraparë me rregullore apo me mënyrë tjetër.
 3. Dekani i përcakton detyrat e prodekanit.

Neni 46

1. Çdo fakultet ka Këshillin e Fakultetit, anëtarët e të cilit janë:
 - 1.1. Dekani;
 - 1.2. Prodekani(ët);
 - 1.3. Sekretari i Kolegjit;
 - 1.4. Drejtorët e departamenteve;
 - 1.5. Një përfaqësues i profesorëve të rregullt
 - 1.6. Dy përfaqësues të profesorëve të asocuar;
 - 1.7. Tre përfaqësues të profesorëve asistentë;
 - 1.8. Pesë përfaqësues të asistentëve;
 - 1.6. Një anëtar i zgjedhur nga personeli joakademik i fakultetit;

1.7. Katër përfaqësues të studentëve, të zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.

Neni 47

1. Mandati i anëtarëve akademikë dhe joakademikë të këshillit është katër vjet.
2. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një vit.
3. Mandati i tyre fillon më një (1) tetor.

Neni 48

1. Dekani e kryeson Këshillin e fakultetit. Në mungesë të dekanit, një nga prodekanët kryeson këshillin sipas radhës së përparësisë të caktuar nga dekani.
2. Dekanet e fakulteteve formojnë Kolegjiumin e dekanëve të cilin e udhëheq Rektori. Kolegjiumit i dekanëve nxjerr rregullore të veçant për organizimin e punës së vet.

Neni 49

1. Këshilli i fakultetit ka këto përgjegjësi dhe detyra:
 - 1.1. Të propozojë kandidatin për postin e dekanit për t'u miratuar nga Senati;
 - 1.2. T'i japë këshilla dhe propozime Këshillit Drejtues dhe Senatit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fakultetin, personelin e tij, strukturën dhe organizimin e brendshëm;
 - 1.3. T'i propozoj Senatit planprogramet dhe ndryshimet në planprograme, të japë rekomandime në metoda të mësimdhënies, në fusha të studimeve shkencore dhe për çështje të tjera akademike;
 - 1.4. Të mbikëqyrë progresin e studentëve si dhe të kërkimeve shkencore apo të krijimtarisë artistike në fakultet;
 - 1.5. Të propozon numrin dhe të përcakton kushtet për regjistrim të studentëve të rinj, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Këshilli drejtues dhe Senati;
 - 1.6. Të përcaktojë dhe zbatojë masat e duhura për sigurimin e cilësisë dhe për vlerësim në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Senati;
 - 1.7. Të hartojë raportet vjetore të punës për rektorin;

- 1.8. Të merret me çështje tjera që ndërlidhen me çështje akademike;
- 1.9. Të merret me çështje të tjera të cilat janë të përcaktuara me këtë Statut ose që kërkohen nga Këshilli drejtues apo Senati.

Neni 50

1. Çdo fakultet ka Këshillin e studentëve. Ky është autoritet që i përfaqëson të gjithë studentët e fakultetit.
2. Numri i anëtarëve përfaqësues nga rradhët e studentëve përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Kolegjit.
3. Procedura për zgjedhjen e tyre caktohet me rregulloren e nxjerrë nga Parlamenti i Studentëve.
4. Mandati i anëtarëve të Këshillit të studentëve është i kufizuar në dy vite pa mundësi për rizgjedhje.

Neni 51

1. Këshilli i studentëve shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve në fakultet.
2. Këshilli i studentëve realizon interesat e veta, lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor, përmes përfaqësuesve të vet në këshillin e fakultetit.
3. Anëtarët studentë të këshillit të fakultetit marrin pjesë në propozimin e kandidatëve për dekan.

Neni 52

II.5.1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore është njësi akademike e Kolegjit i angazhuar për mësimdhënie dhe për kërkime të aplikuara shkencore në disiplinat akademike përkatëse. Mësimdhënia akademike e tij përqendrohet në programet e studimeve të orientuara në praktikë, duke ndjekur konceptin e Institucioneve të Shkencave Mjekësore të Aplikuara të Evropës.

2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore e përqendron profilin e vet arsimor dhe kërkimor për nevojat e vendit, në riaftësimin dhe për mësimin gjatë gjithë jetës të profesionistëve, si dhe ofron shërbime praktike për partnerët vendorë.
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka të drejtë të themelojë institute për kërkime praktike në fusha të caktuara, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorët privatë ose publikë, me miratim të Këshillit drejtues.

Neni 53

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore ofron këto lloje të studimeve:
 - 1.1. Studimet themelore - bachelor;
 - 1.2. Studimet master; profesionale (të diplomuarit në master profesional nuk mund të regjistrohen në studimet e doktoratës shkencore) dhe shkencor

Neni 54

1. Në përbërjen e vet Fakulteti i Shkencave Mjekësore i ka këto departamente:
 - 1.1. Departamentin e Infermierisë;
 - 1.2. Departamentin e Fizioterapisë
 - 1.3. Departamentin e Mjekësisë Sanitare
 - 1.4. Departamentin e Radiologjisë Diagnostike dhe
 - 1.5. Departamentin e Biokimisë Laboratorike
2. Në kuadër të departamenteve mund të krijohen Njësitë mësimore, si nënivele të ndarjes hierarkike.

II. 6. Njësia e Edukimit Mjekësor

Neni 55

1. Njësia e Edukimit Mjekësor (më tej: "NjEM") organizon dhe përkrah zhvillimin arsimor të Kolegjit nëpërmjet funksioneve në vijim:

- 1.1. ofrimit të përkrahjes, ndihmës për zhvillim dhe rishqyrtimit të planprogrameve, në bashkëpunim me bordet relevante;
- 1.2. ofrimit të përkrahjes së njësisë së kurseve për implementimin e programit të kursit;
- 1.3. asistimit në zhvillimin e politikave arsimore si dhe të procedurave;
- 1.4. përkrahjes së implementimit të iniciativave programore;
- 1.5. ofrimit të shërbimeve për personelin në lidhje me iniciativat/problemet arsimore;
- 1.6. zhvillimit dhe trajnimit të personelit mbi teknikat adekuate të mësimdhënies (përqendrimi në studentë, punës në grupe të vogla, MBP, etj.) dhe zhvillimit arsimor;
- 1.7. zhvillimit të studentëve drejtë mësimi me teknikat e mësimi të drejtuara kah studenti;
- 1.8. përkrahjes dhe inicimit të hulumtimit në fushën e arsimimit shëndetësor/mjekësor;
- 1.9. ofrimit të pikës themelore për diskutimin/këmbimin e ideve nga arsimimi mjekësor.

2. Punën e NjEM e drejton udhëheqësi i kësaj njësie. Udhëheqësi emërohen nga rektori për një periudhë tri vjeçare, me mundësi të vazhdimi edhe për një mandat.

Neni 56

1. Qëllimet dhe detyrat e NjEM janë:

- 1.1. ofrimi i shërbimeve profesionale të nivelit të lartë arsimor për përkrahjen dhe intensifikimin e rolit mësimdhënës të Kolegjit
- 1.2. ndërmarrja e hulumtimeve dhe aktiviteteve zhvëllimore, të cilat do të themelojnë një reputacion kombëtar dhe ndërkombëtar, si qendër e shkëlqyeshme në fushën e arsimimit mjekësor

- 1.3. ofrimi i informatave arsimore dhe i këshillave si dhe ndihma për implementimin e praktikës më të mirë arsimore të pranuar ndërkombtarisht brenda planprogramit
- 1.4. aktivitetet në fushat e planifikimit të planprogramit, aktivitetit mësimdhënës e mësimor dhe të vlerësimit
- 1.5. asistimi në zhvillimin e aftësisë së mësimdhënësve që të planifikojnë dhe të japin aktivitete arsimore të studimeve themelore të cilësisë së lartë
- 1.6. ofrimi i mundësisë së zhvillimit të personelit nëpërmjet vendosjes së marrëdhënieve bashkëpunuese me organizatat e tjera të ngjashme
- 1.7. përgjegjësinë për operimin e qendrave për shkathtësi klinike dhe inkurajimin e shfrytëzimit të teknologjisë informative për komunikim ndërmjet personelit dhe të studentëve për mësim nga distanca dhe mësim të pavarur
- 1.8. zhvillimi i lidhjeve efektive ndër-profesionale bashkëpunuese me grupet lokale brenda dhe jashtë Kolegjit
- 1.9. zhvillimi i një ambienti efektiv për mësim në rrjetë, i cili do të përkrahë efektivisht menaxhimin e planprogramit.

Neni 57

1. Detyrat specifike të NjEM lidhur me zhvillimin e planprogrameve janë:

- 1.1. të punohet me përgjegjësit për planifikimin e planprogramit për vazhdimin e zhvillimit dhe të implementimit të planprogrameve të cilësisë së lartë, të cilat i përmbushin kërkesat statutore të organeve profesionale
- 1.2. promovimin dhe përfshirjen në inovacionet brenda planprogramit, të cilat reflektojnë praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe shpijnë deri në atë që Kolegji të njihet si qendër e shkëlqesisë për programet arsimore të saj
- 1.3. ofrimi i këshillave arsimore profesionale dhe të dëshmuara për Fakultetin dhe personelin e tij
- 1.4. zhvillimi dhe mbajtja e një baze të dhënave për informim arsimor, në veçanti aty ku nuk ka në dispozicion revista dhe forma të tjera konvencionale të komunikimit
- 1.5. ofrimi i këshillave të specializuara mbi vlerësimin

1.6. marrja e rolit kryesor në zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e një programi të vlerësuar të planprogrameve

1.7. të ndihmojë zhvillimin e një programi për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies

1.8. të ndihmojë qasjen ndaj ekspertëve të jashtëm si dhe ekspertizën në fushën e arsimimit mjekësor.

Neni 58

1. Në kuadër të NjEM themelohet Komisioni për Evaluimin Permanent të Plaprogrameve studimore (në tekstin e mëtejme: KEPP). Detyrat e KEPP janë të përcaktuara në nenin 52 të kësaj Rregulloreje.

2. KEPP përbëhet prej 19 anëtarëve, prej të cilëve 5 anëtarë janë nga radhët e studentëve.

3. Zgjedhja zgjat për periudhën prej tre (3) vjetësh, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Mandati i delegatëve studentë zgjat një vjet.

4. Udhëheqësi dhe anëtarët e Komisionit, nga radhët e stafit akademik zgjedhen nga Këshillat e fakulteteve, kurse anëtarët studentë delegohen nga Parlamenti studentor.

Neni 59

1. Detyrat specifike të NjEM lidhur me zhvillimin e personelit, i realizon nëpërmjet Zyrës për Resurse Humane. Detyrat e kësaj zyreje janë:

1.1. identifikimi i nevojave për personel në fushat e mësimdhënies, planifikimit të kursit të planprogramit, vlerësimit, si dhe zhvillimit të shkathtësive personale në fushat relevante

1.2. përgjigja në nevojat e identifikuara duke i ndihmuar personelit të përvetësojë shkathtësitë e kërkuara për planifikimin, ofrimin dhe vlerësimin e aktiviteteve arsimore të cilësisë së lartë të edukimit themelor

1.3. përgatitja e planeve konkrete për zhvillimin e stafit dhe inkurajimin për përfshirjen aktive në këto programe

- 1.4. mbajtja e seminareve, takimeve të punës dhe kurseve për të asistuar personelin për përparimin e shkathtësive të tyre mësimdhënëse
- 1.5. përkrahja e hulumtimeve arsimore të ndërmarra nga personeli brenda NjEM-it dhe nga personeli dhe studentët e shoqëruar me NjEM
- 1.6. inicimi i një sistemi të klinikistëve të identifikuar me interesim për të punuar me NjEM ashtu që i gjithë personeli me interesim të veçantë të arsimit mjekësor të ketë lidhje formale dhe të jenë në gjendje të marrin pjesë në aktivitetet të rregullta akademike dhe sociale
- 1.7. lajmërimi i personelit lidhur me çështjet e rëndësishme të teknikave arsimore dhe të arsimit mjekësor në veçanti
- 1.8. ofrimi i shembullit të planifikimit dhe ofrimit kompetent të mësimin
- 1.9. zhvillimi i politikave për rekrutimin e stafit akademik
- 1.10. regjistrimi i stafit ekzistues dhe regjistrimi i publikimeve të stafit akademik sipas impakt pikëve të fituara.

Neni 60

1. Zyra për Resurse Humane e ka udhëheqësin dhe dy anëtarë, në mandat prej pesë vjetësh, me mundësi të rizgjedhjes.

Neni 61

1. Detyrat specifike të NjEM lidhur me hulumtim janë:
 - 1.1. zhvillimi i programit hulumtues, i cili arrin një nam ndërkombëtar për cilësinë e tij
 - 1.2. zhvillimi i fushave të caktuara të ekspertizës, të cilat do të themelojnë namin e NjEM, si qendër e shkëlqesisë
 - 1.3. inkurajimi dhe përkrahja e aktiviteteve hulumtuese të anëtarëve të personelit akademik
 - 1.4. angazhimi në tërheqjen e fondeve për hulumtime arsimore
 - 1.5. zhvillimi i lidhjeve bashkëpunuese me grupe tjera hulumtuese lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare

1.6. promovimi i një programi të ligjëruesve vizitorë për stimulimin e kreativitetit të personelit akademik lokal.

Neni 62

1. Detyrat specifike të NjEM lidhur me objektet arsimore janë:

1.1. përgjegjësia për zhvillimin dhe operimin e qendrave të shkathtësive klinike në Universitet

1.2. sigurimi i objekteve adekuate mësimdhënëse që iu vihen në dispozicion studentëve

1.3. zhvillimi i strategjive të TI, të cilat do të përfshijnë nevojën për pajisje adekuate kompjuterike dhe të komunikimit në një spektër të hapësirave mësimore

1.4. promovimi i mënyrave me të cilat objektet mësimore të Kolegjit do të mund të shfrytëzoheshin nga organizatat e jashtme

Neni 63

1. Detyrat specifike të NjEM lidhur me aktivitetet bashkëpunuese janë:

1.1. themelimi i lidhjeve efektive ndër-profesionale me individë, grupe dhe organizata, me interes dhe/ose përgjegjësi për të gjitha aspektet e arsimit themelor

1.2. zhvillimi i marrëdhënieve efektive me shkollat brenda Kolegjit

1.3. përfshirja aktive me institucionet tjera dhe organizatat me interes për arsimimin mjekësor brenda regjionit dhe jashtë tij

1.4. themelimi i marrëdhënieve strategjike të nivelit të lartë me një numër më të vogël të institucioneve jashtë vendit, të cilat kanë interesa të përbashkëta për zhvillimin arsimor dhe hulumtimin

1.5. zhvillimi dhe promovimi i takimeve arsimore të punës dhe i konferencave nga fusha e arsimit mjekësor, të cilat tërheqin njerëz drejt Kolegjit dhe intensifikojnë namin e tij si qendër shkëlqesie.

Neni 64

1. Detyrat specifike të NjEM lidhur me teknologjinë informative janë:

- 1.1. zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të TI për Universitet
- 1.2. marrja e përgjegjësisë për zhvillimin e një ambienti mësimdhënës dhe mësimor të bazuar në rrjetë
- 1.3. ofrimi dhe zhvillimi i qasjes së bazuar në TI ndaj menaxhimit të kursit
- 1.4. asistimi për përparimin e niveleve të komunikimit ndërmjet personelit akademik e administrativ, si dhe të studentëve, duke shfrytëzuar metodat e bazuara në TI
- 1.5. bashkëpunimi me grupe tjera brenda dhe jashtë Kolegjit, të cilat mund të ndihmojnë në shtytjen para të objektivave

Neni 65

1. Udhëheqësi i NjEM, i përgjigjet Rektorit për:

- 1.1. menaxhimin e NjEM-it
- 1.2. udhëheqjen e zhvillimeve strategjike për mësim dhe mësimdhënie si dhe për implementimin e ndryshimeve
- 1.3. kryesimin e grupit të politikave të planprogramit
- 1.4. sigurimin e organizimit efikas të mësimdhënies dhe të vlerësimit
- 1.5. udhëheqjen e rishqyrtimeve të rregullta të planprogramit të studimeve themelore dhe vlerësimit për të mundësuar futjen e ideve dhe të metodave të reja
- 1.6. mbikqyrjen e procesit të auditimit të cilësisë së kurseve dhe sigurimit të harqeve të informimit kthyes
- 1.7. intensifikimin e mësimdhënies së shkathtësive klinike nëpërmjet zhvillimit të një laboratorit të shkathtësive klinike
- 1.8. ndërlidhjen me të tjerët në fushën e kujdesit shëndetësor dhe mësimdhënies për promovimin e shfrytëzimit efikas të mundësive mësimore.

Neni 66

1. NjEM-në e përbëjnë: udhëheqësi i NjEM, Prorektorët e Kolegjit, sekretari i Kolegjit, dekanët e fakulteteve, shefat e departamenteve dhe një student.
2. NjEM, sipas nevojës, mund të propozojë themelimin e komisioneve të ndryshme me fusha specifike të veprimit, ose njësi të reja organizative në kuadër të vetvetes. Propozimet aprovohen nga Senati i Kolegjit.
3. NjEM gëzon përkrahje sekretariale nga personeli administrativ i Kolegjit.

Neni 67

II. 7. Bordi i Ekzaminimeve

1. Detyrat e Bordit të Ekzaminimeve:

- 1.1. të përpiloj dhe kontrolloj hartën e provimeve;
 - 1.2. të kontrolloj metodat e vlerësimit, kriteret vlerësuese dhe sistemin e vlerësimit;
 - 1.3. të kontrolloj besueshmërinë dhe vlefshmërinë e testeve ose pyetjeve të caktuara në test në bazë të kërkesës së Dekanit, prodekanëve, NNjeM, NNjShBioM, NNjMK, udhëheqësve të katedrave, mësimeve, tutorëve ose studentëve;
 - 1.4. merret me analizën e të dhënave lidhur me ekzaminimet;
 - 1.5. pranon raportet statistikore të suksesit për çdo lëndë mësimore;
 - 1.6. organizon provimin provimin përfundimtar;
 - 1.7. përpilon katalogun e përmbajtjes së provimeve përfundimtare në bashkëpunim me udhëheqësit e bordeve mësimore për të cilat lëndë organizohet provimi.
2. BE-në e përbëjnë: Udhëheqësi i BE, tre mësimeve vendor dhe tre mësimeve të huaj.
 3. Udhëheqësi dhe anëtarët emërohen nga KMSH.

Neni 68

II. 8. Departamentet

1. Në kuadër të Kolegjit funksionojnë këto Departamente: Departamenti i Shkencave Themelore, Departamenti i Shkencave Klinike, Departamenti i Infermierisë, Departamenti i Fizioterapisë, Departamenti i Mjekësisë Sanitare, Departamenti i Radiologjisë Diagnostike, Departamenti i Biokimisë Laboratorike.

Neni 69

1. Detyrat e Departamenteve janë:

- 1.1. përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave të kurseve individuale/moduleve/shtrirjeve klinike në përputhje me objektivat e përcaktuara të programeve arsimore;
- 1.2. planifikimi, organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies;
- 1.3. përcaktimi i ekzaminuesve të jashtëm;
- 1.4. të veprojnë dhe të referojnë për raportet e ekzaminuesve të jashtëm;
- 1.5. të implementojnë procesin e vlerësimit në përputhje me rregullat e Kolegjit, të përcaktuara nga Senati;
- 1.6. të sigurojnë mekanizmin e përshtypjeve kthyesë (feedback-ut) përbrenda kurseve;
- 1.7. të menaxhojnë me resurset mësimore;
- 1.8. të sigurojnë bashkëpunimin ndërmjet stafit akademik dhe studentëve.

Neni 70

1. Departamentet i përbëjnë të gjithë mësimdhënësit e kurseve të përfshira në fushën gjegjëse arsimore.
2. Secili departament zgjedh shefin e departamentit, me mandat 3 vjeçar dhe mundësi të vazhdimit edhe për një mandat.

II. 9. Sekretari i Kolegjit

Neni 71

1. Kolegji ka sekretarin e vet.
2. Kandidatët që konkurojnë për postin e sekretarit të Kolegjit duhet të përmbushin këto kushte:
 - 2.1. të kenë diplomë universitare nga fusha e drejtësisë, ekonomisë apo shkencat shoqërore;
 - 2.2. të kenë së paku tre vjet përvojë pune;
 - 2.3. të kenë aftësi të dëshmuara organizative dhe menaxhuese;
 - 2.4. të kenë njohuri të mjaftueshme për procesin e arsimit.

Neni 72

1. Sekretari i Kolegjit ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 1.1. është zyrtari më i lartë i administratës;
 - 1.2. është zyrtar përgjegjës për udhëheqje efektive të Kolegjit;
 - 1.3. është përgjegjës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sisteme informative të menaxhimit dhe për përgatitjen dhe organizimin e të dhënave për menaxhim;
 - 1.4. është zyrtar përgjegjës për përgatitjen teknike të procesit buxhetor;
 - 1.5. mbajtjen e evidencës së rregullt për kandidatët e paraqitur në konkursin për pranimit, të studentëve të regjistruar, të diplomuar, të personelit me kontratë, dokumentacionin e pronës, etj.
 - 1.6. dhënien e mendimeve dhe përgatitjen e akteve të tjera të Kolegjit;
 - 1.7. është përgjegjës për çështje të tjera që kërkohen nga Këshilli Drejtues dhe Rektori, të cilat nuk janë përcaktuar me këtë Statut.

Neni 73

1. Sekretari i përgjigjet Rektorit për udhëheqje efektive të Kolegjit. Në këtë pozitë sekretari përgjigjet për të gjitha çështjet që nuk janë kompetencë e organeve, ose e udhëheqësve të tjerë.

2. Sekretari i Kolegjit zgjidhet nga Këshilli Drejtues, sipas propozimit të Rektorit, të bazuar në konkursin publik.
3. Sekretari i Kolegjit emërohet për një periudhë prej pesë vitesh, me mundësi të riemërimit për një periudhë të pakufizuar.

III. PUNONJËSIT E KOLEGJIT

III.1. Stafi akademik dhe joakademik

Neni 74

1. Të gjitha vendet e punës do të bazohen në kontratat me normë të plotë dhe kontratat me gjysëm normë.
2. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontrata tjetër të punësimit me normë të plotë mbrenda apo jashtë Kolegjit.
3. Përjashtimin nga kjo rregull e lejon rektori nëse kërkesa për këtë ka arsyeshmëri të fortë.

Neni 75

1. Stafin akademik të Kolegjit e përbëjnë personat e angazhuar në mësimdhënie akademike, kërkime shkencore dhe mësim klinik.
2. Personeli akademik përbëhet nga:
 - 2.1. Profesorët e rregullt (Prof. Dr.)
 - 2.2. Profesorët e asocuar (Prof. Asoc. Dr.)
 - 2.3. Profesorët asistentë (Prof. Ass. Dr.)
 - 2.4. Ligjëruesit (Ligj.)
 - 2.5. Asistentët (Ass.)
 - 2.6. Asistentët e rinjë (Ass. i ri)
 - 2.7. Mentorët klinikë (Ment.kl.)
3. Asistentët dhe asistentët e rinj përbëjnë kategorinë e bashkëpunorëve.

Neni 76

1. Personelin jo akademik të Kolegjit e përbëjnë personat e angazhuar në administratë dhe punë teknike.

2. Përgjegjësitë dhe kualifikimet e larta për çdo post përcaktohen me rregullore të vaçantë për sistematizim të vendeve të punës.

Neni 77

1. Kushtet për emrimin dhe avansimin në çfardo titulli të personeli akademik janë kualifikime përkatëse, përvoja relevante për vendin e punës, vlerësimi në rishikimin e performancës së tij, si dhe certifikata për kurset e përfunduara lidhur me metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit.

Neni 78

1. Për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;

1.2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:

1.2.1. një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, si autor i pare ose korrespondent;

1.2.2. pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;

1.2.3. përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;

1.2.4. aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;

1.2.5. aftësi për udhëheqje akademike;

1.2.6. udhëheqje të temave master dhe të doktoratës.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen për kohë të pacaktuar.

Neni 79

1. Për titullin e profesorit të asocuar kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare, si autor i pare ose korrespondent;
 - 1.3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
 - 1.4. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e lëmit përkatës.
2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.

Neni 80

1. Për titullin e profesorit asistent kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.2. Të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare, si autor i pare ose korrespondent;
 - 1.3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie.
 - 1.4. Të ketë së paku tri vite përvojë pune në procesin mësimor në Arsimin e lartë.
2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 3 vite.

Neni 81

1. Për titullin e ligjëruesit kandidati duhet të përmbushë këto kritere:
 - 1.1. Të ketë gradën shkencore "Magjistër i shkencave" ose ekuivalent me të që konsiderohet specializimi në kohëzgjatje më së paku 3 vite dhe të ketë provoj pune së paku 3 vjetë si specialist i lëmit, ose të ketë të regjistruar studimet pasdiplomike të doktoratës dhe të ketë provojë në mësimdhënie së paku 5 vjet në institucionet e arsimit të lartë.

1.2. Të ketë aftësi të larta arsimore dhe pedagogjike dhe të marrë pjesë active në zhvillimin akademik dhe institucional të institucioneve të arsimit të lartë

1.3. Të ketë të realizuar së paku 8 referime të shkurtëra ose paraqitje (postera) në konferenca dhe kongrese shkencore, nga të cilat së paku 5 duhet të jetë i nivelit ndërkombëtar (simposiume, konferenca, kongrese) ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencorë dhe janë botuar në librin e rezymeve.

1.4. Të ketë botuar së paku një artikull shkencor origjinal në revista shkencore me bord editorial.

Neni 82

1. Për titullin e asistentit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet Master në drejtimin përkatës, përkatësisht të ketë të përfunduar Fakultetin e mjekësisë (në rastin e lëndëve klinike të ketë të përfunduar specializimin apo te jete te pakten ne vitin e trete te specializimit ne rastin e rizgjedhjes).

1.2. Të jetë jo me i vjetër se 35 vjet kur emërohet për herë të parë. Përfundimisht kandidati mund te zgjedhet asistent deri ne moshen 40 vjeçare nëse ka gradën e doktorit te shkences.

1.3. Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës me rastin e rizgjedhjes;

1.4. Te ketë notën mesatare në studimet bachelor dhe master jo me pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.

2. Të gjitha emërimet si dhe kohëzgjatja e punësimit zgjat 3 vite.

3. Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet bachelor dhe master. Përfundimisht asistenti që është rizgjedhur, në mungesë të profesorit për lëndën, mund te autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet bachelor me autorizimin e këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimitdhënësi nga departamenti.

Neni 83

1. Për titullin e "Mentorit Klinikë" duhet ti plotësoj këto kushte:

- 1.1. Të ketë përfunduar specializimin nga lëmi gjegjës.
- 1.2. Të ketë provoj pune së paku 3 vjet si specialist i lëmit.
- 1.3. Të ketë aftësi të larta arsimore dhe pedagogjike dhe të marrë pjesë active në zhvillimin akademik dhe institucional të institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 84

1. Titulli 'Profesor Emeritus' u jepet profesorëve më të suksesshëm, kur arrijnë moshën e pensionit.
2. Titulli caktohet nga Senati me propozim të Këshillit të fakultetit përkatës dhe me përkrahjen e së paku dy këshillave të njësive akademike.
3. "Profesori Emeritus" ka të drejtë të jap mësim dhe të mirret me punë shkencore në pajtim me kualifikimet e tij dhe kërkesave të veçanta të Kolegjit.
4. Të drejtave dhe përgjegjësive të "Profesorit Emeritus" caktohen me kontratë individuale të lidhur nga rektori.

Neni 85

1. Zgjedhja e personelit akademik bëhet në mënyrë transparente, në bazë të konkursit publik.
2. Senati publikon konkursin për zgjedhje të personelit akademik rregullisht dy herë në vit: në muajin shkurt dhe shtator. Në rast nevojë, Senati mund të publikojë edhe më shumë konkurse gjatë vitit.
3. Konkursi zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit.

Neni 86

1. Të gjitha emërimet bëhen pas shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve nga komisioni vlerësues profesional, i formuar nga Këshilli i Fakultetit. Anëtar i komisionit vlerësues profesional nuk mund të jetë bashkëshorti, partneri ose anëtari i familjes së ngushtë të kandidatit që duhet të emërohet.
2. Komisioni vlerësues interviston kandidatët të cilët konsiderohen se i kanë përmbushur kushtet për postin e ofruar.

3. Brenda afatit të caktuar Komisioni profesional dorëzon raportin me shkrim, me propozim konkret për një nga kandidatët, i cili më së miri plotëson kushtet për zgjedhje.
4. Propozimin nga alineja 3 e këtij neni i dërgohet KMSH, i cili e bën zgjedhjen, ndërsa Rektori lidh kontratën për punë për periudhën për të cilën janë zgjedhur në bazë të dispozitave ligjore.
5. Zgjedhja në thirrje shkencore-mësimore profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe bëhet në kohëzgjatje prej katër vitesh, kurse për professor asisten në kohëzgjatje prej 3 vitesh.
6. Zgjedhja në thirrje asistent i ri, asistent dhe mentor klinik bëhet në kohëzgjatje prej tri vitesh.
7. Ajo mund të përsëritet me rekomandimin e KMSH.

Neni 87

1. Kontrata e punës me personelin akademik mund të ndërpritet para kohe në rast:
 - 1.1. dënimi për vepër penale me të cilën diskreditohet Kolegji sipas procedurës së përcaktuar me rregullore të veçantë të Kolegjit;
 - 1.2. të shkeljes së rënd të kodeksit të etikës së personelit akademik, në bazë të procedurës së parashikuar me atë kodeks;
 - 1.3. të paaftësisë për të ushtruar detyrën për shkaqe fizike ose mentale, të dëshmuar me raportin e mjekut;
 - 1.4. se me sjelljet e tij cenon rendin, autoritetin dhe dinjitetin e Kolegjit, sipas procedurës së parashikuar me rregullore të veçantë;
 - 1.5. se sipas procedurës së parashikuar me rregullore, vërtetohet se është i korruptuar.

Neni 88

1. Këshilli drejtues me propozimin e Senatit do të nxjerrë rregulloret e kodit etik të punonjësve të Kolegjit.

III.2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit akademik

Neni 89

1. Personeli akademik ka lirin e shprehjes dhe të mësimdhënies.
2. Personeli akademik ka lirin për të publikuar rezultatet e punës së tyre kërkimore shkencore e profesionale.
3. Personeli i Kolegjit gëzon lirinë e organizimit dhe të tubimit në pajtim me ligjin.
4. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të personelit akademik në bazë gjinie, race, gjendje martesore, besimi fetar, mendimi politik, apo mendimi tjetër, origjine etnike apo sociale, përkatësie nacionale, statusit pronësor, etj., si me rastin e zgjedhjes, ashtu edhe gjatë punës dhe aktivitetit të personelit në Fakultet.

Neni 90

1. Personeli akademik i Kolegjit është i obliguar të respektojë:
 - 1.1. frymën e humanizmit,
 - 1.2. autonominë e Kolegjit,
 - 1.3. lirinë e kreativitetit shkencor,
 - 1.4. aktet ligjore dhe vendimet e bazuara në të,
 - 1.5. parimet e ndershmërisë profesionale dhe shkencore,
 - 1.6. kodin etik,
 - 1.7. reputacionin e Kolegjit dhe të ndikojë në përmirësimin e tij.

Neni 91

1. Personeli akademik gjatë procesit arsimor është i obliguar t'i përmbushë këto detyra:
 - 1.1. të përgatitë dhe të ofrojë mësimet, seminarët, ushtrimet dhe format e tjera të mësimit;
 - 1.2. të përgatitë tekste universitare dhe literaturë të përshtatshme për studime brenda strukturës së kursit;

- 1.3. të mbikëqyrë punimet seminarike, punimet e diplomës dhe punimet tjera kërkimore të studentëve;
 - 1.4. të zbatojë sistemin e përshtypjeve kthyesë për studentët;
 - 1.5. të angazhohet në mbikëqyrjen e rregullt të progresit të studentëve;
 - 1.6. të sigurojë mbajtjen pa pengesë të provimeve gjatë afatit të caktuar të provimeve;
 - 1.7. të merr pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe të komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë këto detyra me përkushtim dhe sinqeritet.
2. Personeli duhet të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me përkushtim dhe sinqeritet.
3. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të punëtorëve nuk marrin pjesë në takime të organeve qeverisëse të Kolegjit.

Neni 92

1. Stafit akademik 60% të veprimtarisë së vet duhet ta përmbushë nëpërmjet aktivitetit arsimor të tij, 30% nëpërmjet aktivitetit kërkimoro-shkencor dhe 10% nëpërmjet aktivitetit administrativ-teknik.
2. Si indikatorë dhe parametra të performancës që ka të bëjë me përfshirjen e stafit akademik në hulumtim, minimumi i pritjes është që çdo anëtar i rregullt i stafit akademik duhet të publikojë së paku një dokument shkencor në vit për tre vitet e fundit.

III.3. Procedurat disiplinore

Neni 93

1. Personeli akademik i Kolegjit në punën, veprimtarinë dhe sjelljet e veta duhet t'i përshtatet parimeve morale dhe etike, parimeve të së vërtetës shkencore dhe ta mbrojë autoritetin e Kolegjit në mënyrën e paraparë me etikën e personelit akademik.

2. Cenimi i rregullave të sjelljes dhe moskryerja e obligimeve të përcaktuara me Rregulloren mbi procedurën disiplinore, me kodeksin e etikës dhe me aktet e tjera të Kolegjit nga personeli akademik dhe nga personat e tjerë të zënë me punë në Institucion, tërheqë përgjegjësinë disiplinore.
3. Procedura disiplinore përcaktohet me rregulloren mbi procedurën disiplinore të Kolegjit, të cilin e nxjerr Senati, në pajtim me ligjin, në pajtim me Statutin, me Kodin e Etikës dhe akteve të tjera të Kolegjit.
4. Me propozimin e Këshillit Drejtues themelohet Komiteti i Etikës.
5. Komiteti i Etikës përbëhet nga:
 - 3 (tre) anëtarë nga radhët e mësimdhënësve të Kolegjit dhe
 - 2 (dy) anëtarë nga stafi administrativ i Kolegjit.
 - Përfaqësuesi i studentëve merr pjesë në seancat kur objekt i diskutimeve janë studentët.
6. Mandati i Komitetit të Etikës është 4 vjeçar. Mandati i përfaqësuesit të studentëve është një vit.
7. Kryetari i këtij Komiteti duhet të jetë njëri nga anëtarët e emëruar nga fusha profesionale e drejtësisë ku emërimi i tij bëhet me Vendim nga Këshilli Drejtues.

IV. STUDENTËT DHE ORGANIZIMI I STUDIMEVE

IV.1. Studimet dhe programet e studimeve

Neni 94

1. Studimet akademike organizohen dhe zhvillohen si:

- 1.1. studime themelore
- 1.2. studime pasdiplomike

Neni 95

1. Studimet themelore mund të zgjasin 5 vjet (300 ECTS) ose 3 vjet (180 ECTS), përkatësisht 4 vjet (240 ECTS).
2. Me përfundimin e studimeve studentët fitojnë thirrjen e përcaktuar si në programin e studimeve.

Neni 96

1. Studimet pasdiplomike organizohen si studime pasdiplomike për master nga lëmenjtë e caktuar.
2. Studimet master zgjasin 2 vjet (120 pikë të ECTS-së).

Neni 97

1. Përfundimi me sukses i studimeve themelore është kusht për regjistrimin e studimeve pasdiplomike master.
2. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master fitohet thirrja akademike master i shkencave mjekësore.

Neni 98

1. Me planet dhe programet mësimore detajisht përcaktohen kushtet të cilat duhet të plotësohen për çdo lloj të studimeve.
2. Planet dhe programet mësimore i miraton Senati me propozim të Komisioni për Evaluimin Permanent të Plaprogrameve studimore, i cili në procesin e evaluimit e përfshinë edhe Komisionin e studimeve, i cili e ka hartuar atë program.

Neni 99

1. Programet e studimit përmbajnë:
 - 1.1. Titullin e studimit;
 - 1.2. Llojin e studimit;
 - 1.3. Thirrjen akademike (Titullin akademik);
 - 1.4. Kushtet për regjistrim;
 - 1.5. Objektivat dhe rezultatet;
 - 1.6. Hollësitë mbi planprogramin;
 - 1.7. Vlera në pikë sipas ECTS (Lëndët, punimi i diplomës);
 - 1.8. Kushtet për studime individuale.

Neni 100

1. Me rastin e përcaktimit të planit mësimor, Kolegji duhet posaçërisht të kujdeset që programi:
 - 1.1. përmbushë standardet e larta të mësimnxënies dhe të mësimdhënies
 - 1.2. të jetë bashkëkohorë dhe që i përshtatet mundësive dhe interesave të studentëve;
 - 1.3. të jetë i krahasueshëm me universitetet e tjera të ngjashme në shtetet e zhvilluara;
 - 1.4. rezultatet e të mësuarit duhet të jenë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë.

Neni 101

1. Çdo mësimdhënës është i obliguar që në fillim të vitit shkollor t'ia dorëzojë Kolegjit, përkatësisht NjEM, programin mësimor për lëndën e vet, në formë të shkruar dhe elektronike, dhe t'i njoftojë studentët me të.
2. Krahas syllabusit të lëndës dorëzon edhe planin operacional për kurin e tij.
3. Fakultetet në fillim të çdo viti akademik e bëjnë listën e mësimdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve për tërë vitin akademik, sipas programit të studimeve.
3. Rishikimet periodike të Programit bëhen çdo tre vjet nga Komisioni i Studimeve.

Neni 102

Komisioni i studimeve

1. Komisioni i studimeve themelohet në çdo njësi akademike të Kolegjit si organ këshillëdhënës për këshillin e kësaj njësie akademike.
2. Komisioni i studimeve themelohet për secilin program ndërdisiplinar dhe program të përbashkët të studimeve të Kolegjit, si organ këshillëdhënës për Senatin, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 103

1. Komisioni i studimeve është përgjegjës për:
 - 1.1. Hartimin e propozimeve të programeve të reja të studimeve;
 - 1.2. Përshtatjen dhe ndryshimin e programeve ekzistuese të studimit;
 - 1.3. Rishikimin e vazhdueshëm të teksteve universitare;
 - 1.4. Kërkesat për ndërrimin e programeve të studimeve nga studentët;
 - 1.5. Përgatitjen e lëndës për ankesat e studentëve;
 - 1.7. Vlerësimin e studentëve.
2. Detyrat e Komisionit të studimeve janë: zhvillimi i koncepteve, vlerësimi dhe komentimi i kërkesave në mënyrë që të përgatis raporte për të cilat vendoset në Senat apo në Këshillin e njësisë përkatëse.

Neni 104

1. Anetaret e Komisionit te studimeve nuk duhet të jenë doemos anëtarë të Senatit apo të këshillit të njesise akademike. Komisioni i studimeve ka kete perberje :

1.1. Prorektori ose prodekani për mësim (kryesues);

1.2. Pesë profesorë;

1.3. Një asistentë;

1.4. Dy studentë me note mesatare se paku tete (8).

2. Anëtarët e personelit akademikë zgjidhen nga Senati ose këshilli i njesise akademike. 3. Anëtari student zgjidhet nga parlamenti i studentëve.

4. Kohëzgjatja e mandatit është tre vjet për stafin dhe një vit për studentin.

Neni 105

1. Viti akademik fillon me 1 tetor të vitit vijues dhe përfundon me 30 shtator të vitit të ardhshëm.

2. Mësimi organizohet nëpër semestra (semestri dimëror, që zgjatë prej 1 tetor deri më 15 janar dhe semestri veror, që zgjatë prej 15 shkurt deri më 31 maj të vitit vijues).

IV.2. Pranimi në studime

Neni 106

1. Të drejtën për regjistrim në Institucion e kanë të gjithë kandidatët banorë të Kosovës dhe shtetasit e huaj pa nënshtetësi të Kosovës që jetojnë në mënyrë të përhershme në Kosovë.

2. Shtetasit e huaj pa nënshtetësi të Kosovës dhe pa banim të përhershëm në Kosovë kanë të drejtë të regjistrimit në Institucion sipas kushteve të përcaktuara nga MASHT, ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, apo të marrëveshjeve bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjetinstitucional.

Neni 107

1. Kushtet për pranim në studimet themelore në Institucion janë:

- 1.1. përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë, i vërtetuar me diplomë;
- 1.2. përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme në shtete të tjera me më së paku 12 vjet të shkollimit, të vërtetuar me diplomë përkatëse;
- 1.3. autorizim i veçantë lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.

Neni 108

1. Pranimi në studime bëhet në bazë të konkursit publik dhe në bazë të procedurës për zgjedhjen e studentëve.
2. Kriteret e vlerësimit i cakton Këshilli i Fakultetit.

Neni 109

1. Vendimin për shpallje të konkursit e merr Këshilli i Fakultetit.

Neni 110

1. Studenti fiton të drejtën e regjistrimit në vitin më të lartë të studimeve nëse i kryen të gjitha detyrimet e përcaktuara me planin dhe programin mësimor, rregulloren mbi studimet dhe aktet e tjera të përgjithshme.
2. Studenti mund të regjistrojë sërish të njëjtin vit të studimeve sipas kushteve të përcaktuara me Rregulloren mbi studimet, duke i përmbushur detyrimet financiare ndaj Kolegjit.

Neni 111

1. Studenti duhet t'i mbarojë studimet themelore universitare brenda një periudhe që nuk tejkalon dyfishin e periudhës normale të paraparë për studimet të cilat i ka regjistruar, me përjashtim të rasteve të veçanta për të cilat vendosë KMSH.

Neni 112

1. Studenti humb statusin e studentit:

- 1.1. kur përfundon studimet;
- 1.2. kur çregjistrohet;
- 1.3. kur nuk regjistrohet në vitin më të lartë, ose në të njëjtin vit të studimeve;
- 1.4. me vendim nga procedura disiplinore;
- 1.5. kur nuk i kryen studimet në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin paraprak të këtij Statuti;
- 1.6. në raste të tjera të përcaktuara me Rregulloren e Kolegjit.

IV.3. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 113

1. Studentët kanë të drejtë:

- 1.1. të marrin pjesë në sesionet e ndryshme mësimore;
- 1.2. të përdorin të gjitha pajisjet e Kolegjit për plotësimin e punës së tyre mësimore e shkencore sipas programeve përkatëse;
- 1.3. të përdorin bibliotekën dhe sallat e leximit;
- 1.4. të marrin pjesë në zgjedhjet për postet e studentëve në organizmat e ngritura në bazë të Statutit të Kolegjit dhe akteve të tjera përkatëse;
- 1.5. të përfaqësohet në struktura qeverisëse të Kolegjit, të parapara me organogram të Kolegjit;
- 1.6. të ushtrojnë ankesë lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies, ose lidhur me lokalet në të cilat mbahet mësimi.

Neni 114

1. Studentët kanë këto detyrime:

- 1.1. të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga planet mësimore;
- 1.2. të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga Fakulteti;
- 1.3. të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- 1.4. të ruajnë prestigjin dhe dinjitetin e Kolegjit.

Neni 115

1. Studenti e fiton të drejtën e regjistrimit të vitit më të lart të studimeve nëse deri në fund të afatit për regjistrim i ka përmbushur të gjitha obligimet mësimore për lëndët e dëgjura në vitin paraprak, i ka përfunduar të gjitha provimet e parapara me program dhe i ka përmbushur të gjitha obligimet financiare ndaj Kolegjit.
2. Studenti i cili nuk e ka fituar të drejtën për regjistrimin e vitit më të lartë të studimeve e bën përsëritjen e vitit të njëjtë të studimeve, duke shënuar në index dhe në formularin për regjistrim semestrat që i përsëritë thye për numrin për të satën herë e bën përsëritje e të njëjtit vit (psh. V-VI/1).
3. Në vitin e përsëritur studenti regjistron lëndët nga të cilat nuk i ka përmbushur obligimet mësimore dhe nuk i ka kryer provimet. Këto lëndë i shënohen në formularin për regjistrim të semestrit dhe në vendim.
4. Për këtë studentëve iu lëshohet vendimi, i nënshkruar nga prorektori për mësim, i cili përmban të gjitha obligimet mësimore dhe financiare të studentit për vitin e përsëritur.

Neni 116

1. I njëjti vit i studimeve më së shumti mund të regjistrohet dy herë rradhazi.
2. Statusin e studentit të rregullt studenti e ka gjatë gjithë kohës së studimeve deri në diplomim, respektivisht deri në përfundim të vitit shkollor në të cilin studenti i bën 10 vjet të studimeve, për studimet 5 vjeçare, përkatësisht 6 vjet për studimet 3 vjeçare, përfshirë këtu edhe një vit të statusit të absolventit.

Neni 117

1. Detyrimet mësimore të studentëve mund të pezullohen për periudhë të caktuar kohore në raste të veçanta të përcaktuara me Rregulloren e studimeve.

Neni 118

1. Në rast të shkeljes së detyrimeve të studentit, kundër tij mund të ngritët procedura disiplinore në bazë të rregullores së posaçme të Kolegjit.

2. Masa më e lehtë disiplinore është vërejtja publike, kurse masa më e ashpër është përjashtimi i përhershëm nga Fakulteti.

Neni 119

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej komisionit disiplinorë të Kolegjit, të emëruar nga KMSH.

2. Ankesat dorëzohen KMSH të Kolegjit, mbrenda 15 ditëve pas shpalljes së vendimit.

3. Ankesa vendoset nga KMSH.

IV.4. Organizimi i studentëve

Neni 120

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizatën studentore të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët.

2. Organizata e studentëve ka statutin e vetë që aprovohet nga antarët e sajë.

Neni 121

1. Në kuadër të Kolegjit interesat e studentëve përfaqësohen nëpërmjet Parlamentit të studentëve në nivel të Kolegjit, dhe ate:

1.1. Shtatë (7) përfaqësuesve në Senat

1.2. Nga dy (2) përfaqësues në Këshillet e Fakulteteve

1.3. Pesë (5) përfaqësuesve në Komisionin për Evaluimin Permanent të Programeve.

1.4. Një (1) përfaqësues në Njësin e Edukimit Mjekësor

Neni 122

1. Anëtarët për parlamentin e studentëve dhe përfaqësuesit e studentëve në organet qeverisëse të Kolegjit do të zgjedhen në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.
2. Mandati i përfaqësuesve të studentëve në organet vendimarrëse, ekzekutive dhe konsultative është i përcaktuar me Statut të Kolegjit.

Neni 123

1. Organizimi brenda organizatës studentore është autonom dhe rregullohet me statut të Parlamentit studentor.

IV.5. Metodatat e vlerësimit

Neni 124

1. Dija e studentit vlerësohet në mënyrë periodike nëpërmjetë vlerësimit të vazhdueshëm dinamik, kollokvijumeve, vlerësimit të njohurive bazë dhe vlerësimit të shkathtësive klinike.
2. Provimet jepen nga të gjitha kurset të cilat studenti i ka regjistruar në bazë të materies së përcaktuar me programin mësimor, përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me planprogram.
3. Provimit mund t'i nënshtrohet studenti i cili kryen të gjitha obligimet e përcaktuara me këtë Statut dhe me aktet tjera të Kolegjit.

Suksesi i arritur në provim është publik.

Neni 125

1. Provimet janë publike dhe studenti ka të drejtë të kërkojë që publiku të jetë i pranishëm gjatë provimit.

Neni 126

1. Sukses i studentit shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).
2. Nota 5 (pesë) shprehë suksesin e pamjaftueshëm dhe për të mbahet evidencë e posaçme.

Neni 127

1. Afatet e rregullta të provimeve janë: afati i janarit, afati i qershorit dhe afati i shtatorit.
2. Të gjitha afatet e provimeve janë fikse dhe publikohen.
3. Afati i jashtëzakonshëm është afati i prillit, ndërsa për absolventët është afati i nëntorit.
4. Në fund të studimeve organizohet provimi përfundimtar.
5. Provimi ka për qëllim integrimin e njohurive nga shkencat klinike të përfshira në programet e viteve në vijim dhe vlerësimin e shkallës së kompetencave të fituara të kandidatit që gradohet, karshi njohurive dhe kompetencave të përcaktuara me programet mësimore të Kolegjit dhe të Ministrisë së Shëndetësisë.
6. Përmbajtja e provimit përfundimtar publikohet në formë të katalogut të veçantë.

Neni 128

1. Orari i provimeve shpallet në fillim të çdo viti akademik për të gjitha afatet.
2. Dispozitat më detaje lidhur me metodat e vlerësimit parashihen me Rregulloren e studimeve.

IV.6. Titujt akademikë dhe diplomat

Neni 129

1. Sipas kushteve për akreditim të parapara me ligj, Kolegji jep këta tituj akademikë dhe diploma:
 - 1.1. diplomë për studime themelore;
 - 1.2. diplomë për studimet themelore Bachelor i shkencave (BSc) dhe

1.3. diplomë për studimet pasdiplomike master i shkencave (MSc)

Neni 130

1. Vlerësimi për studime themelore do të bëhet sipas Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) në tërë Fakultetin.
2. Studentëve do t'iu mundësohet bartja e kredive nga Kolegji në universitetet tjera brenda dhe jashtë vendit.
3. Studentëve do t'iu njihen kreditë e fituara edhe në kurset e akredituara nga ministritë përkatëse.

Neni 131

1. Diploma e studimeve themelore dhe diploma e studimeve Bachelor jepet pas përfundimit të studimeve themelore akademike dhe mbrojtjes publike të punimit të diplomës.

Neni 132

1. Diploma e studimeve pasdiplomike master jepet pas përfundimit të suksesshëm të studimeve përkatëse pasdiplomike, me mbrojtjen publike të punimit të magjistraturës.

Neni 133

1. Vlerësimi në studimet pasdiplomike master bëhet sipas Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS).
2. Studentëve do t'iu mundësohet bartja e kredive nga Kolegji në universitetet tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 134

1. Numri i kredive dhe mënyra e vlerësimit të aftësisë së studentëve në studimet themelore dhe pasdiplomike master përcaktohen me Rregulloren e studimeve.

V. KONTROLLI I CILËSISË DHE VLERËSIMI

Neni 135

1. Me qëllim të ruajtjes së cilësisë dhe kontrollës së kualitetit Kolegji zbaton sistemin e vetë të vlerësimit të cilësisë dhe kualitetit.
2. Vlerësimet i nënshtrohen të gjithë dhe ky vlerësim përfshin gjithë spektrin e Kolegjit dhe shërbimet e tij.
3. Vlerësimet analizojnë efikasitetin dhe efektshmërinë e funksionimit të Kolegjit në të gjitha fushat e veprimit. Ai u siguron njësive të vlerësuara dhe organeve përgjegjëse të qeverisjes treguesit për masat e sigurimit dhe përmirësimin e cilësisë, si dhe me vendimet që kanë të bëjnë me personelin dhe organizimin.

Neni 136

1. Procedurat për kontrollin e cilësisë dhe të vlerësimit realizohen nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë, e themeluar brenda Kolegjit, dhe udhëheqen në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit.
2. Zyra për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga një grup i vogël i stafit akademik, të emëruar nga Rektori dhe i aprovuar nga Këshili Drejtues. Ekipa përfshinë Prorektorin për Bashkëpunim me Jashtë dhe Cilësi, një zyrtarë administrativ të zyrës, një anëtar i NjEM, anëtarë të tjerë të stafit akademik, të ko-optuar kohë pas kohe, sipas nevojës dhe qëllimeve specifike, si dhe përfaqësues të Parlamentit Studentor.

Neni 137

1. Vlerësimet kanë për qëllim:
 - 1.1. motivimin dhe vlerësimin publik në rastë të rezultateve positive
 - 1.2. zbatimin e masave të përshtatëshme me qëllim të përmirësimit të punës në rast të rezultateve negative

Neni 138

1. Raportet e vlerësimit do të merren parasysh nga organet e qeverisjes së Kolegjit.

Neni 139

1. Brenda Kolegjit bëhen këto vlerësime:

- 1.1. vlerësimi i planprogrameve të studimeve
- 1.2. vlerësimi i organizimit të studimeve
- 1.3. vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies
- 1.4. vlerësimi i aktiviteteve kërkimore-shkencore e profesionale
- 1.5. vlerësimi i njohurive të fituara dhe i kompetencave klinike të fituara te studentët

Neni 140

1. Vlerësimi i planprogrameve të studimeve bëhet nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e planprogrameve, që kanë për qëllim vlerësimin e punës së katedrave dhe të NJEM lidhur me zhvillimin dhe implementimin e planprogrameve të cilësisë së lartë, vlerësimin e përmbushjes së kërkesave statutore të organeve profesionale, promovimin dhe përfshirjen e iniciativave brenda planprogrameve, të cilat reflektojnë praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Neni 141

1. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve, aktiviteteve kërkimore-shkencore e profesionale bëhet nëpërmjet:

- 1.1. vlerësimin të brendshëm (vetëvlerësimin) nëpërmjet:
 - 1.1.1. pyetësorëve për vetëvlerësim nga ana e personelit akademik
 - 1.1.2. pyetësorëve për vlerësim nga ana e studentëve
 - 1.1.3. analiza e raporteve të punës së katedrave
- 1.2. vlerësimin të jashtëm (ndërkombëtar) nëpërmjet:
 - 1.2.1. raporteve të ekspertëve të jashtëm
 - 1.2.2. participimit në orët mësimore

Neni 142

1. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve bëhet në fund të çdo semestri.
2. Pyetësorët anonim përpilohen nga komisioni i emëruar nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë.
3. 10% e rezultateve më të mira vjetore të vlerësimit të cilësisë së mësimit do të publikohen në Fakultet.
4. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimit do të diskutohen në nivel të katedrave kurse për 10% të rezultateve më të ulëta vjetore duhet të propozohen masat që duhet ndërmarrë për përmirësimin e cilësisë së mësimit.

Neni 143

1. Për të gjitha vlerësimet përgatitet raporti me shkrim, i cili duhet të përmbajë procecurat e vlerësimit, rezultatet e vlerësimit dhe masat e propozuara.
2. Njësitë e vlerësuara kanë afatin e përcaktuar kohorë brenda 7 ditëve për të reaguar ndaj raportit të vlerësimit. Komentet duhet të dorzohen me shkrim.
3. Zyra për Sigurimin e Cilësisë, pas shqyrtimit të komenteve, përgatitë raportin final të vlerësimit, të cilin ia dorëzon organeve qeverisëse të Kolegjit.

Neni 144

1. Vlerësimi i brendshëm bëhet me nismën e Këshillit Drejtues, Senatit ose Rektorit.
2. Njësitë e Kolegjit dhe organet e tyre të qeverisjes janë të obliguara të sigurojnë të dhënat e nevojshme dhe informatat për vlerësim si dhe të bashkëpunojnë.

Neni 145

1. I gjithë personeli akademikë vlerësohet rregullisht në bazë institucionale së paku çdo vit.
2. Të gjithë kryesuesit dhe udhëheqësit e instituteve apo nënnjësive të tjera organizative të Kolegjit do të sigurojnë raportin vjetor të punës dhe përmbushjes së detyrave për dekanët e njësive të tyre akademike.

3. Raporti i punës vjetore përmban:

- Të dhënat e fundit rreth mësimit në vitin akademik;
- Të dhënat për punën kërkimore të vitit të fundit kalendarik.

4. Çdo dekan i njësisë akademike i siguron rektorit raport të plotë vjetor të punës së njësisë së vet akademike.

5. Raporti i punës dhe i përmbushjes së detyrave përmban të dhëna të mjaftueshme lidhur me:

- Numrin e studentëve (të regjistruar, numrin total, të diplomuarit);
- Mësimdhënien akademike
- Programet e studimit dhe lëndët;
- Mësimdhënësit, përgjegjësitë e mësimdhënësve dhe ligjëratat e dhëna;
- provimet dhe punimet seminarike;
- diplomat dhe punimet e masterit;
- rezultatet e vlerësimit të studentëve.

Kërkimet shkencore:

- artikujt e botuar shkencor, monografitë dhe botimet tjera shkencore;
- raportet e projekteve shkencore;
- pjesëmarrjet në konferenca dhe punimet e paraqitura;
- projektet kërkimore të financuara nga burimet publike dhe private;
- personelin akademik të financuar nga burimet private;
- parametrat e tjerë relevantë të kërkimit shkencor;

6. Të gjitha të dhënat e kryerjes së detyrave raportohen më së voni deri më 31 mars të vitit vijues.

7. Raportet e punës do të përpilohen, mblidhen dhe ruhen në mënyrë të kompjuterizuar dhe standarde.

8. Administrata e Kolegjit siguron instrumentet e duhura për mbledhjen e të dhënave për mënyrën e punës dhe është përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave dhe analizën e të dhënave.

9. Personi kompetent i çdo njësie akademike vendos për të drejtën e qasjes në të dhënat e njësisë. Sekretari si përfaqësues administrativ i rektoratit, dhe si personi më i lartë kompetent në lidhje me këtë ka qasje të pakufizuar në të gjitha të dhënat.

VI. FINANCIMI

Neni 146

1. Për sigurimin e veprimtarisë së vet Kolegji siguron mjete financiare nga këto burime:

- 1.1. tarifatat e shkollimit, tarifatat administrative dhe pagesat tjera që i bëjnë studentët;
- 1.2. pagesat për shërbimet komerciale dhe shërbimet tjera;
- 1.3. fondet e Ministrisë të Buxhetit të Kosovës për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm;
- 1.4. donacionet, dhuratat dhe ndihmat;
- 1.5. kontratat me organizatat kombëtare, ndërkombëtare, publike, ose private në fushën e mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore, etj.

Neni 147

1. Kolegji ka llogarinë rrjedhëse.
2. Mjetet e realizuara nga neni paraprak i kësaj Rregulloreje derdhen në llogarinë rrjedhëse të Kolegjit.

Neni 148

1. Metodologjia e financimit, kushtet e tij dhe kontrolli financiar përcaktohen më detajisht me Rregulloren e Kolegjit.

Neni 149

1. Mbikëqyrja dhe menaxhimi i funksioneve të buxhetimit dhe të kontabilitetit të Kolegjit kryhet nga Zyra për Financa, si zyrë e specializuar për çështje financiare, që funksionon si njësi mbështetëse e Kolegjit
2. Zyra për Financa udhëheqet nga një administrator i lartë, kompetent për fushën ekonomike.

3. Zyra për Financa angazhohen edhe zyrtarë të tjerë administrativ për çështje specifike financiare.
4. Administratori i lartë i Zyrsë për Financa bashkëpunon me Sekretarin e Kolegjit, kurse i jep llogari Këshillit Drejtues dhe Rektorit.

Neni 150

Kontrolli financiar

1. Me qëllim të vendosjes të një efikasiteti më të madh operacional, një disipline më të madhe buxhetore dhe fiskale si dhe respektimin e rregullave lidhur me shfrytëzimin e drejtë të mjeteve, Kolegji në pajtim me Ligjet në fuqi krijon funksionin e auditimit të brendshëm.
2. Auditimi i brendshëm është aktivitet i pavarur këshillëdhënës që ndihmon Kolegjin në përmbushjen e objektivave të saj, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.
3. Autoritetet e Kolegjit do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë e auditorit të brendshëm.
4. Auditori i brendshëm do të ushtroj aktivitetet e veta në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
5. Këshilli Drejtues, rektori, sekretari dhe auditorët, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, kanë të drejta të pakufizuara për qasje në të gjitha të dhënat dhe dokumentet zyrtare të Kolegjit dhe personelit të tij.
6. Auditimi bëhet së paku një herë në vit.

Neni 151

1. Në pajtim me Ligjet në fuqi Kolegji i nënshtrohet, në baza vjetore, një auditimi të jashtëm të rregullsisë dhe të kontrollit financiar nga autoriteti i përcaktuar me Ligj.
2. Autoriteti i përcaktuar me Ligj i dorëzon Kolegjit një raport mbi auditimin e rregullsisë.

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 152

1. Me datën e aprovimit të këtij Statuti ndërprehen së vlejtori Statuti paraprak.

Neni 153

1. Statuti mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të saj.

Neni 154

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Kolegjit.